



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 84 Akti**

**Nr. 138 Vendimi**  
**Tiranë, më 09.04.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 29 mars 2019, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ferdinand Elezi**, prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, pa përfaqësues.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Ferdinand Elezi, i cili në seancën dëgjimore publike, të datës 29.03.2019, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- a- Z. Ferdinand Elezi, për shkak të funksionit të tij si prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016<sup>1</sup>;
- b- Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 4, - i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj; Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici - pasi administroi dhe studioi tre raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 30.01.2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, znj. Alma Faskaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit;
- c- Më pas, për arsye objektive pamundësie, në bazë të vendimit nr. 40, datë 16.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e dosjeve të çështjeve të komisionerit Alma Faskaj”, nëpërmjet procedurës së shortit, anëtarja e trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj, u zëvendësua nga komisionere Firdes Shuli;
- d- Në vijim të hapave hetimorë, më datë 6 mars 2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues, vendosi të mbyllë fazën hetimore, dhe në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për z. Ferdinand Elezi, të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht në kontrollin e pasurisë, të figurës dhe në atë profesional;
- e- Më datë 07.03.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë

---

<sup>1</sup> Paragrafi 3, i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

- shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 21 mars 2019; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative;
- f- Më datë 21.03.2018, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij të shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht;
  - g- Më datë 27.03.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3 vendosi të ftojë – përmes postës elektronike - subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 29 mars 2019 – datë në të cilën u zhvillua rregullisht seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 edhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma;
- ii. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë hetimeve të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit, dhe të kaluara si barrë prove;
- iii. Pasi dëgjoi relacionin, z. Ferdinand Elezi, shprehu qëndrimin e vet, duke parashtruar shpjegimet përkatëse të detajuara lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij;
- iv. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit gjatë seancës paraqiti pranë Komisionit shpjegimet dhe konkluzionet e tij përfundimtare, edhe me shkrim, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion, subjekti kërkoi konfirmimin e tij në detyrë;
- v. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, vendosi ta konkludojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin, z. Ferdinand Elezi, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit;
- vi. Seanca dëgjimore e datës 29.03.2019 u ndërpre, për të rifilluar në datën 09.04.2019 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Ferdinand Elezi ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje sa herë është pyetur dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpjegimet e tij, edhe në lidhje me burimet financiare të personave të tjerë, me të cilët ai kishte pasur marrëdhënie financiare apo juridiko-civile.

#### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, ‘Vetting’”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) raportet dhe informacionet mbi Kontrollin e Figurës, të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja;
- d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;
- d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë të bërë nga ai në seancën dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- e) deklaratimet e personave të lidhur apo të tjerë të lidhur;
- f) faktet e njohura botërisht.

##### **A - Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.01.2018, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

##### **Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e

ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

**Mbi pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, për rivlerësim, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:**

- Apartament banimi, me sip. 124 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë në datën 05.09.2000, e deklaruar në deklaratën “Vetting”, me një vlerë prej 40,000 USD;
- Njësi – zyrë, me sip. 45 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Durrës, blerë në datën 01.04.2005, në vlerën 60,000 euro;
- Apartament banimi, me sip. 185 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Durrës, blerë në datën 23.08.2005, në vlerën 30,000 euro;
- Apartament banimi, me sip. 185 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Durrës, i blerë në datën 15.12.2007, në vlerën 4,000,000 lekë.

**1- Apartament banimi, me sip. 124 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.**

- i. Në lidhje me këtë pasuri, të blerë në datën 05.09.2000, rezulton se subjekti e ka deklaruar atë në deklaratën “Vetting” me një vlerë prej 40,000 USD. Nga kjo shumë, 4,000,000 lekë rezultojnë të paguara nëpërmjet një kredie të butë, sipas VKM-së nr. 102, datë 05.03.1999, – për trajtimin me kredi për strehimin e funksionarëve të lartë shtetëror – dhe diferenca është mbuluar nga kursimet e akumuluar ndër vite;
- ii. Është konstatuar gjithashtu se në deklaratën e vitit 2003, është deklaruar nga subjekti: *“Shtëpi banimi me sip. 124 m<sup>2</sup>, në Tiranë, Rr. “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2000, në vlerën 5,000,000 lekë. Burimi: nga kredia bankare në vlerën 4 milion lekë, sipas VKM-së”*. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar burimi i të ardhurave lidhur me diferencën e çmimit, veç kredisë, që përdorur për blerjen e kësaj pasurie;
- i. Për rrjedhojë, ka rezultuar se ka mospërputhje të vlerës totale të blerjes së kësaj pasurie dhe pasaktësi nga ana e subjektit në deklaratimet e kryera për këtë pasuri si dhe në lidhje me burimin e diferencës së çmimit, përtej shumës së paguar nëpërmjet kredisë;

**1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

- ii. Në shpjegimet e tij, z. Ferdinand Elezi, ka pohuar se pasaktësitë kanë qenë pasojë e përlllogaritjes së kursit të këmbimit të ndryshëm nga ana e Komisionit, pasi po të merret në konsideratë kursi i datës kur është kryer deklarimi, çmimi i konvertuar përkon me atë të deklaruar dhe pagesat e kryera janë 4 milion lekë dhe 10.000 USD, pavarësisht se në kontratë është shënuar shuma 40.000 USD;

- iii. Gjithashtu, subjekti ka shtuar se ai kishte dhënë shpjegime shteruese mbi këtë pikë edhe në ILDKPKI, në qershor të vitit 2016, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues mbi pagesën nga ana e tij të shumës prej 10.000 USD, në favor të shitësit, dhe konkretisht mandatar këtë nr. \*\*\*, datë 24.07.2000, që provon derdhjen e shumës në fjalë në arkën e shoqërisë ndërtuese;

## 1.2 Vlerësimi i trupit gjykues

- iv. Komisioni, çmon se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, kanë qenë bindëse dhe se është provuar pagesa e shumës së përcaktuar si çmim për shitblerjen e pasurisë në fjalë;
- v. Pasaktësitë dhe mospërputhjet e deklarimeve, si më lart, duket se janë fryt i përlogaritjes së ndryshme të çmimit, të diktuar nga luhajtja e kursit të këmbimit USD - lekë, në varësi të momentit të ndryshëm të marrë në konsideratë si pikë referimi<sup>2</sup>, të cilat gjithsesi, në vetvete nuk mund të pasjellin pasoja për subjektin.

## 2- Njësi – zyrë, me sip. 45 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Durrës.

Në lidhje me këtë pasuri, të blerë në datën 01.04.2005, në vlerën 60.000 euro, nga hetimi administrativ, ka rezultuar se:

- i. Sipas kushteve të parashikuara në kontratën e shitblerjes së kësaj pronësie, të lidhur më datë 01.04.2005, rezulton se vlera prej 50.000 eurosh është likuiduar plotësisht para datës së lidhjes së kontratës;
- ii. Më datë 07.04.2005, kjo pasuri e paluajtshme është regjistruar pranë ZVRPP-së Durrës, si dhe është lëshuar edhe certifikata përkatëse e pronësisë;
- iii. Ndërsa nga dokumentacioni i administruar, rezulton se vetëm në datën 19.04.2005, palës shitëse nëpërmjet “Bankës Amerikane”, dega Durrës, i ka kaluar vlera prej 50.000 eurosh nëpërmjet sistemit bankar. Pra, kjo transfertë bankare është kryer 18 ditë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes në fjalë dhe 12 ditë pas kryerjes së regjistrimit të kësaj prone në ZVRPP. Ky fakt bëri që të lindë dyshimi lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie, ose mbi një fiktivitet të mundshëm lidhur me datën e kryerjes së pagesës në fjalë pasi, ose zyra është blerë 110 mijë euro, ose nuk është e vërtetë që shuma prej 50.000 euro të jetë paguar para datës 01.04.2005 – siç është specifikuar në kontratën e kësaj date;
- iv. Nuk dokumentohet kalimi i pjesës së çmimit të mbetur, pas pagesës prej 50.000 euro. Pra, diferenca prej 10.000 euro me burim të deklaruar nga kursimet nuk dihet nëse është paguar, kur dhe si është kaluar ajo tek pala shitëse;

---

<sup>2</sup> Komisioni ka përdorur kursin mesatar vjetor sipas Bankës së Shqipërisë, ndërsa subjekti ka përdorur atë që përkon me datën e kryerjes së veprimi bankar/pagesës.

Rezultatet e mësipërme ishin bazuar në dokumentet e sipërcituara, dhe konkretisht në:

- a. Kontratën shitblerjes së datës 01.04.2005;
- b. Kërkesa e bërë në datën 14.04.2005, për marrjen e kredisë pranë “Bankës Amerikane”;
- c. Shkresa e “Bankës Amerikane” e datës 19.04.2005, për kalimin e shumës prej 50,000 euro tek pala shitëse;
- d. Certifikata e lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës e datës 07.04.2005.

## 2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- v. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “... pavarësisht se në kontratën e datës 01.04.2005 rezultojnë me përkufizimin standard të përdorur nga noteri, si ‘e likuiduar plotësisht para lidhjes së kontratës’, sqarohet se sipas udhëzimeve të punonjësve të bankës dhe garancisë bankare që ata i dhanë shitësit si dhe mirëbesimit normal të vendosur midis nesh, vendosën kalimin e pronësisë...”;
- vi. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se për sa më lart është bërë me qëllim përdorimin e kësaj pasurie për të vendosur barrë hipotekore, në garanci të kredisë së marrë, si dhe ka paraqitur deklarata noteriale të shitësve (M. dhe K. N.), për konfirmimin e rrethanave të mësipërme;
- vii. Lidhur me çmimin mesatar të tregut të njësisve tregtare të shitura në afërsi të pasurisë në fjalë, subjekti ka kërkuar marrjen e provave të reja dhe dëgjimin e disa dëshmitarëve, të cilat trupi gjykues nuk i konsideroi të rëndësishme për vendimmarrje, në zbatim të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016;

## 2.2 Vlerësimi i trupit gjykues

- viii. Në analizë të fakteve, rrethanave, qëndrimit të subjektit dhe dokumentacionit që lidhen me blerjen e kësaj pasurie, Komisioni, konstatoi se shpjegimet e subjektit janë të besueshme, pasi – veç të tjerash – ai e pranon faktin se, ndryshe nga sa është përshkruar në kontratën e shitblerjes, shumën prej 50.000 eurosh nuk është paguar para nënshkrimit të kontratës në fjalë, por që ajo do të paguhej pasi të disbursohej kredia e kërkuar nga blerësit. Ky fakt rezultoi i pasqyruar në mënyrë të qartë edhe në shkresën e “Bankës Amerikane”, të datës 15.03.2005, me nr. \*\*\* prot;
- ix. Për sa më lart, Komisioni, ngriti pikëpyetjen nëse mospërputhja midis përmbajtjes së kontratës dhe veprimeve (datave) reale të kryera nga palët përbëjnë një fiktivitet dhe nëse ky mospërkim pasjell pasoja për subjektin, nga momenti që ai ka qenë palë kontraktore;
- x. Trupi gjykues, çmon se fiktiviteti shoqërohet me një qëllim të dytë të fshehur, i cili në realitet është objektivi i vërtetë i kontratës duke përdorur objektin formal, të përshkruar në aktin noterial thjesht si fasadë. Në rastin konkret, rezultoi se objekti, qëllimi dhe efektet reale të kontratës në fjalë përkohë me njëra-tjetrën dhe me veprimet e kryera konkretisht, por ka një diferencë lidhur vetëm me datën e kryerjes së pagesës prej 50.000 euro;

- xi. Kjo pasaktësi është e përshkruar me vetëdije nga palët, me qëllim mundësimin e regjistrimit të pasurisë, një praktikë e njohur edhe nga banka,<sup>3</sup> dhe për rrjedhojë ajo rezulton të mos jetë një veprim fiktiv i mirëfilltë, pasi nuk ka qëllim fshehjen e realitetit apo mashtrimin ndaj të tretëve, por gjithsesi është e veshur me nuanca fiktiviteti – pasi pasqyron një veprim juridiko-bankar si të kryer (pagesën në fjalë), ndërkohë që ai ende nuk ishte kryer realisht;
- xii. Komisioni vlerëson se, ndonëse mospërputhja e sipër përshkruar nuk përbën në vetvete një element të mjaftueshëm për aplikimin e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, me pasoja direkte për shkarkimin e subjektit, kjo rrethanë mund të vlerësohet nën këndvështrimin etik, në ndërthurje me elemente të tjerë, të mundshëm, që lidhen pikërisht me aspektin etiko-profesional të subjektit.

### **3- Apartament banimi, me sip. 185 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Durrës.**

Në lidhje me këtë pasuri, blerë në datën 23.08.2005, në vlerën 30,000 euro, ka rezultuar se:

- i. Subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë në fazën e ndërtimit, karabina;
- ii. Kjo pasuri rezulton e regjistruar në ZVRPP-në Durrës përpara datës së shitblerjes së pronës dhe ky fakt bën të lindin dyshime nëse pasuria ka qenë ende karabina në momentin e shitblerjes;
- iii. Vlera e blerjes së kësaj pasurie nuk përkon me çmimet e tregut dhe as me kostot mesatare të ndërtimit, pasi sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 23.11.2005, vlera e apartamenteve në qytetin e Durrësit është më e lartë;
- iv. Gjithashtu, edhe deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit se apartamenti është blerë dhe marrë në dorëzim i papërfunduar, në gjendje karabina<sup>4</sup>, dhe se për përfundimin e tij është shpenzuar shuma prej 760.000 lekësh, në tërësinë e shpenzimeve për përfundimin e punimeve në këtë apartament, nuk justifikohet, gjithsesi, vlera e çmimit të blerjes në total e deklaruar me vlerën reale të tregut (si më lart);

Rezultatet e mësipërme ishin bazuar në dokumentet si vijon:

- a. *Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme, datë 23.08.2005 e lidhur nga subjekti me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.;*
- b. *Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 23.11.2005, lidhur me vlerat e shitjes në tregun e lirë të pasurive të paluajtshme për qytetin e Durrësit;*
- c. *Përgjigje e ZVRPP-së Durrës (shkresa nr. \*\*\* prot., datë 21.03.2018);*
- d. *Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorë.*

<sup>3</sup> Sipas subjektit, kjo mënyrë e pasqyrimit të pagesës si të kryer totalisht në momentin e nënshkrimit të kontratës është sugjeruar pikërisht nga punonjësit e bankës në fjalë, pasi ishte *modus operandi*.

<sup>4</sup> Edhe sipas deklarimit periodik vjetor mbi pasuritë, f. \*\*\*, pika nr. \*\*\*.



### 3.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- v. Lidhur me vërtetësinë e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, argumenton se kjo provohet nëpërmjet një sërë aktesh dhe kontratash sipërmarrjeje apo shkëmbimi – të administruara nga Komisioni – të lidhura midis së njëjtës kompani ndërtimi “\*\*\*” sh.p.k. – nga i cili subjekti e ka blerë këtë apartament – me blerës të ndryshëm, nga të cilët rezulton jo vetëm se çmimet janë të përafërta, dhe në disa raste edhe më të ulëta, por edhe që shitja e apartamenteve në fjalë është bërë në gjendje të papërfunduar, pra karabina;
- vi. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me mosekzistencën e ndonjë konflikti interesi me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., apo me administratorin dhe ortakun/pronarin e vetëm të saj, H.G.;<sup>5</sup>
- vii. Lidhur me mospërkimin e çmimit të shitblerjes, objekt vlerësimi, me atë të përcaktuar nga Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 23.11.2005, subjekti argumenton se:
  - a. Ky akt nënligjor është konceptuar në muajin nëntor të vitit 2005, ndërkohë që shitblerja në fjalë është kryer në muajin gusht të vitit 2005, dhe për rrjedhojë ai nuk mund të mbahej parasysht në momentin e lidhjes së kësaj kontrate;
  - b. Gjithsesi, udhëzimi në fjalë nuk mund të detyronte një individ lidhur me një marrëdhënie juridiko-civile, nga momenti që liria e tregut e mundëson këtë;
  - c. Në çdo rast, objekti i rregullimit dhe qëllimi i këtij akti nënligjor lidhet me çmimin e referencës mbi të cilin shoqëritë ndërtuese do të duhet të paguajnë tatimet dhe nuk mund të prodhojë efekte apo të kushtëzojë individët në tregun e lirë;
  - d. Duhet mbajtur parasysht fakti që apartamenti është blerë në gjendje karabina dhe se për kompletimin e tij janë shpenzuar shuma të tjera në shtesë të çmimit të blerjes.
- viii. Po ashtu, si subjekti, edhe shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., kanë paraqitur disa kontrata shitblerjeje të disa apartamenteve në gjendje karabina, me çmim të përafërt me vlerën që e ka blerë edhe subjekti i rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi;
- ix. Subjekti ka kërkuar edhe thirrjen si dëshmitarë të disa personave, lidhur me çmimet e shitjes së kryera për apartamente të tjera në të njëjtin pallat, si dhe lidhur me kryerjen e punimeve pas blerjes nga vetë subjekti për të përfunduar gjendjen karabina. Dëshmitarët e mundshëm kishin nënshkruar më herët deklaratat noteriale mbi këto fakte<sup>6</sup>;
- x. Trupi gjykues, në bazë të pikës 6/a dhe 6/b, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, nuk e konsideroi të nevojshme apo të rëndësishme për vendimmarrje, thirrjen dhe dëgjuesën e personave të kërkuar si dëshmitarë nga subjekti, pasi në dosje ekzistonin prova të administruara që dokumentonin disa fakte në këtë drejtim, si dhe për rrethanën se ata e

<sup>5</sup> Sipas deklaratave të institucioneve ku ka ushtruar funksionin subjekti mbi mospasjen e procedimeve ndaj shoqërisë në fjalë dhe ortakut të saj.

<sup>6</sup> Siç është shpjeguar edhe në paragrafin nr. 6.

kishin shprehur qëndrimin e tyre nëpërmjet deklaratave noteriale të paraqitura nga subjekti dhe të administruara nga Komisioni. Ndërsa, shuma e shpenzimeve të kryera për punimet e këtij apartamenti ishte deklaruar dhe saktësuar nga subjekti, si dhe rezultonte, pjesërisht, e provuar nga dokumentacioni i administruar dhe nuk mund të provohej asgjë më shumë, me anë të dëshmitarëve, në lidhje me këtë rrethanë;

### **3.2 Vlerësimi i trupit gjykues**

Nga sa më lart, Komisioni, vlerëson se jemi përballë një shitblerjeje që pasqyron një çmim më të ulët në krahasim me çmimet mesatare të tregut, edhe duke përfshirë shumat e shpenzuara nga subjekti për përfundimin e punimeve të apartamentit në fjalë.

- xi. Për sa i përket gjendjes faktike të kësaj pasurie në momentin e blerjes nga subjekti, mbeten dyshime pasi nuk mund të provohet me saktësi, por bazuar mbi: provat e paraqitura nga subjekti dhe nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., lidhur me shitjet e disa apartamenteve në gjendje karabina; faturat e materialeve të ndërtimit të blera nga subjekti; deklaratën të subjektit, në deklaratën periodike të vitit 2005, që apartamenti në fjalë ishte blerë i papërfunduar dhe në gjendje karabina; deklaratave noteriale të paraqitura nga persona që ishin në dijeni të fakteve, trupi gjykues, vlerëson se në këtë pasuri janë kryer punime shtesë nga subjekti, rrethanë kjo që lë të kuptohet se apartamenti në fjalë nuk është marrë në dorëzim nga subjekti i përfunduar plotësisht, por provohet se ky i fundit ka kryer punime pas blerjes;
- xii. Gjithsesi, duke pasur parasysh, jo vetëm sa më lart, por edhe mungesën e konfliktit të interesit, si dhe provat lidhur me shumë shitje të apartamenteve të tjera, në gjendje karabina dhe me çmime të përafërta apo edhe më të ulëta nga çmimi i paguar nga subjekti, trupi gjykues, vlerëson se në lidhje me këtë veprim juridiko-civil nuk rezulton e provuar as fiktivitet, dhe as ndonjë trajtim preferencial, prezenca e të cilave do të pasillte një përgjegjësi të subjektit në aspektin e etikës;
- xiii. Në një këndvështrim të përgjithshëm, edhe vetëm fakti i realizimit të një blerjeje me përfitime apo kursime shumë më të larta në krahasim me tregun e lirë, ngjall dyshime dhe mund të krijojë një përshtypje jo pozitive lidhur me etikën, si dhe mbi një përfitim të mundshëm nga funksioni që kishte subjekti i rivlerësimit në momentin e kryerjes së shitblerjes në fjalë, por, siç u përshkrua edhe më lart, rezulton se edhe shumë persona të tjerë, me profesione të ndryshme, kanë blerë apartamente në të njëjtin pallat me çmime të ngjashme apo më të ulëta. Për rrjedhojë, Komisioni, çmon se kjo rrethanë – edhe pse mund të hedhë hije mbi etikën, në mungesë të provave mbi ndonjë konflikt interesi apo përfitimi të paligjshëm ose trajtimi preferencial – në vetvete nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.

#### **4- Apartament banimi, me sip. 185 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Durrës.**

Në lidhje me pasurinë e sipërcituar, të blerë në datën 15.12.2007, në vlerën 4.000.000 lekë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se:

- i. Subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë si objekt i papërfunduar në gjendjen karabina nga një i afërm i vet, që e kishte blerë në të njëjtën gjendje faktike, karabina, në vitin 2005;
- ii. Sipas kontratës së shitjes të datës 15.12.2007, të lidhur nga subjekti me N. K, rezulton se ky apartament është blerë nga subjekti i rivlerësimit, me një çmim prej 4 milion lekësh, në gjendje karabina;
- iii. Vlera e blerjes së kësaj pasurie nuk përkon me çmimet e tregut. Sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave, vlera e shitjes në tregun e lirë për qytetin e Durrësit është më e lartë nga ajo me të cilën është shitur ky apartament;
- iv. Gjithashtu, deklarimi i bërë nga subjekti se apartamenti është blerë i papërfunduar, dhe se për përfundimin e punimeve në këtë pasuri janë kryer prej tij shpenzimet në vlerën 1.139.864 lekë, nuk arrin të justifikojnë vlerën e blerjes me vlerën reale të tregut, pasi edhe duke marrë tërësinë e çmimit të blerjes së bashku me shpenzimet për përfundimin e punimeve në këtë apartament, ai mbetet shumë më poshtë vlerës së tregut;

Rezultatet e mësipërme bazohen në dokumentet si më poshtë:

- a- Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme, datë 15.12.2007, e lidhur nga subjekti me N.K;
- b- Udhëzimi i Këshillit të Ministrave, lidhur me vlerat e shitjes në tregun e lirë të pasurive së paluajtshme për qytetin e Durrësit për vitin 2007;
- c- Përgjigje e ZVRPP-së Durrës (shkresa nr. \*\*\*, datë 21.03.2018);
- d- Përgjigje e pyetësorit të subjektit të rivlerësimit;
- e- Dokumentacion provues i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

#### **4.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

- v. Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me: punimet e kryera në këtë apartament; mbi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me shitësen e këtij apartamenti, e cila e kishte blerë atë në gjendje karabina nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me vlerën 30.000 euro, dhe nuk kishte kryer asnjë punim;
- vi. Subjekti argumentoi se Udhëzimi i Këshillit të Ministrave, lidhur me vlerat e shitjes, nuk rregullon marrëdhëniet civile-tregtare midis individëve, por ai referon çmimet e referencës në bazë të të cilave konsiderohet vlera minimale mbi të cilën shoqëritë ndërtuese duhet të paguajnë tatimet;

- vii. Gjithashtu, subjekti sqaroi se çmimi i paguar prej tij ishte i njëjti me të cilin e kishte blerë edhe e afërmja e tij rreth dy vjet më parë, duke i shtuar edhe interesat që ajo mund të kishte përftuar nëse do të kishte depozituar në bankë shumën në fjalë;
- viii. Po ashtu, subjekti, specifikoi se përgjatë dy viteve që shitësja kishte qenë pronare e apartamentit në fjalë, ajo nuk kishte kryer asnjë punim të brendshëm. Pra, e kishte shitur në gjendje karabina ashtu siç e kishte blerë nga ndërtuesi;
- ix. Për më tepër, edhe në lidhje me këtë pasuri, janë paraqitur nga subjekti prova, kërkesa<sup>7</sup> dhe shpjegime si në pasurinë e mësipërme, nr. 3, të cilat – përfshirë edhe qëndrimin dhe arsyetimin e Komisionit mbi kërkesat për prova të reja – konsiderohen si të përshkruara edhe për këtë pasuri, me qëllim evitimin e një përsëritjeje të paragrafëve përkatës;

#### 4.2 Vlerësimi i trupit gjykues

- x. Komisioni, çmon se vlerësimi i rrethanave, akteve, provave dhe bazës ligjore mbi këtë pasuri, është pothuajse i njëjtë me pasurinë e mësipërme, të përshkruar në pikën 3.2, me ndryshimin se në këtë rast shitës është një individ dhe jo shoqëria ndërtuese, dhe se në kontratën e mëparshme të shitblerjes ishte specifikuar që apartamenti shitej në gjendje karabina. Për rrjedhojë, edhe këtu trupi gjykues arrin në të njëjtat konkluzione si në pikën 3.2, në kuptimin që edhe në këtë rast trupi gjykues vlerëson se as në lidhje me këtë veprim juridiko-civil nuk rezulton i provuar ndonjë fiktivitet apo trajtim preferencial, dhe për rrjedhojë nuk konstatohet ndonjë përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit;

#### 5- Apartament, me sip. 77.91 m<sup>2</sup>, në Durrës, ishte në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit me familjarët e saj.

- i. Në deklaratën “Vetting”, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar shumën prej 1 milion lekësh, si të ardhura - 1/4 e çmimit të shitjes në vlerën 4.000.000 lekë, - nga shitja e datës 10.12.2012, të apartamentit në bashkëpronësi, të privatizuar në vitin 1993, në Durrës, me sip. 77,91 m<sup>2</sup>;
- ii. Nuk rezulton që ky apartament të ketë qenë i deklaruar në pjesën takuese përkatëse (1/5), si bashkëpronësi e bashkëshortes së subjektit, në vitin 2004 – vit i martesës së saj me subjektin – dhe as në vitet në vijim;
- iii. Po ashtu, nuk rezulton që të jetë deklaruar shuma prej 1.000.000 lekësh e përfituar nga shitja e pjesës takuese (1/4), si e ardhur në vitin 2012, dhe as si pakësim i pasurisë së saj;
- iv. Rrjedhimisht, në lidhje me pasurinë e sipërcituar, është konstatuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. E. P., ka pasur në bashkëpronësi para vitit 2004 – vit në të cilin ajo është martuar me subjektin – një pasuri apartament, me sip. 77.91 m<sup>2</sup>, i cili është shitur më datë 10.12.2012 – nëpërmjet kontratës nr. 2376/870 – dhe se kjo pasuri nuk është

<sup>7</sup> Të cilat, për sa i përket thirrjes së dëshmitarëve nuk u vlerësuan të rëndësishme apo të nevojshme për vendimmarrje, sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

deklaruar asnjëherë, as në deklaratën periodike të vitit 2004<sup>8</sup> si pasuri në bashkëpronësi, dhe as në deklaratën periodike në vitin 2012 që përkon me momentin e shitjes së saj – as si burim të ardhurash, dhe as si pakësim pasurie;

Rezultati i mësipërm bazohet në dokumentet si më poshtë:

- a- Deklaratat periodike vjetore të pasurisë për vitet 2004 dhe 2012, si dhe ajo “Vetting”;
- b- Kontratë shitje e datës 10.12.2012;
- c- Udhëzimi nr. 6915/2, datë 30.01.2012.

## 5.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- v. Subjektit të rivlerësimit – pasi i ishin njoftuar rezultatet e hetimit – ka pranuar se kjo pasuri nuk ka qenë asnjëherë e deklaruar në deklaratat periodike, por shuma e përftuar nga shitja e saj është përshkruar rregullisht në deklaratën “Vetting”;
- vi. Subjekti argumenton se mosdeklarimi ka qenë një harresë dhe nuk ka pasur për qëllim fshehjen e pjesës takuese të pasurisë, edhe për faktin se ajo ishte privatizuar prej vitit 1993, dhe nuk kishte asnjë lidhje të burimit të krijimit me subjektin, madje as me bashkëshorten e tij, pasi ishte paguar nga prindërit e saj;
- vii. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar përfitimën e shumës prej një milion lekësh nga shitja e apartamentit në fjalë, duke specifikuar se konkretisht familjes së tij i ishin dorëzuar, nga nëna e bashkëshortes, shumat prej 700.000 lekësh në dhjetor të vitit 2012 dhe shuma prej 300.000 lekësh në vitin 2013, si dhe ka kërkuar përfshirjen e këtyre shumave si të ardhura në vitet përkatëse;
- viii. Në lidhje me këtë pronësi – pasi është pyetur nga Komisioni – subjekti i rivlerësimit është përgjigjur si më poshtë vijon:  
*“Banesa prej 77.9 m<sup>2</sup> e shitur në vitin 2012 ka qenë banesë në të cilën ka banuar familja dhe bashkëshortja para vitit 1990. Kjo banesë është privatizuar dhe regjistruar nga babai i bashkëshortes, H. P. Duke qenë se në këtë banesë, në kohën e lidhjes së martesës banonte familja e saj, bashkëshortja nuk kishte pretendime pronësie dhe nuk më është deklaruar nga bashkëshortja kjo bashkëpronësi ligjore. Në kushtet edhe të kujdesit dhe rëndësisë së munguar, në mënyrë të gabuar nga është deklaruar bashkëpronësia ligjore e bashkëshortes në 1/5 të kësaj banese. Pas vdekjes së babait të bashkëshortes në vitin 2012 është bërë dëshmia e trashëgimisë, ku bashkëshortes i përkiste 1/4 pronësi e kësaj banese, e cila është shitur nga bashkëpronarët në vitin 2012, sikurse është deklaruar edhe në deklaratën “Vetting”;*
- ix. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të nënës së bashkëshortes, si dhe ka kërkuar dëgjimin e saj si dëshmitare. Komisioni ka administruar deklaratën noteriale dhe ka vlerësuar si të panevojshme dëgjuesën e znj. F.P., pasi ajo e kishte shprehur qëndrimin e saj nëpërmjet deklaratës në fjalë, në përputhje me pikën 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016;

<sup>8</sup> Në vitin 2004 subjekti është martuar me znj. B. (P.) Elezi;

## 5.2 Vlerësimi i trupit gjykues

- x. Trupi gjykues, pasi ka analizuar dokumentacionin përkatës, arrin në konkluzionin se në rastin konkret nuk mund të konsiderohet fshehje pasurie mosdeklarimi i pjesës takuese të pasurisë në fjalë, pasi të ardhurat prej shitjes së saj janë deklaruar në deklaratën “Vetting”;
- xi. Por nga ana tjetër, trupi gjykues – duke pasur parasysh edhe qëndrimin e Komisionit të Posaçëm të Apelimit, në lidhje me një rrethanë të ngjashme, të shprehur në vendimin nr. 1/2019 (f. 24, pika 67) – çmon se mosdeklarimi i kësaj pasurie në vitin 2004, ashtu si edhe mosdeklarimi i shitjes (pakësimi) të pjesës takuese dhe i përfutimit të të ardhurave prej këtij veprimi juridik, në vitin 2012, i bën këto dy deklarime periodike vjetore të pamjaftueshme, dhe për rrjedhojë në këtë rast gjen aplikim pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## 6- Lidhur me shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për punime të brendshme në dy apartamente në Durrës, të blerë në vitin 2005 dhe në vitin 2007

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe në referim të përgjigjes nr. 11, të pyetësorit 1, dhe të përgjigjes nr. 2, të pyetësorit nr. 2, si dhe dokumentet e bashkëngjitur me këtë të fundit, në krahasim me deklaratimet vjetore periodike të viteve përkatëse, lidhur me deklaratimin e shpenzimeve të kryera për punimet dhe arredimin<sup>9</sup> e të dy apartamenteve me sip. 185 m<sup>2</sup>, në Durrës, ka rezultuar se:

- i. Lidhur me apartamentin me sip. 185 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës, të blerë në vitin 2005, subjekti ka deklaruar – në përgjigjen nr. 2, të pyetësorit nr. 2 – se punimet e brendshme të ndërtimit në këtë apartament janë kryer në periudhën mars - nëntor 2006, dhe se ai ka investuar, për përfundimin e punimeve në fjalë, shumën prej 760.000 lekësh, me burim financiar nga kredia<sup>10</sup> e marrë në muajin mars të vitit 2006, në “Bankën Amerikane”, dega Durrës;
- ii. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, pasi është pyetur nga Komisioni, në përgjigjet nr. 6 dhe 11 të pyetësorit të parë, ka deklaruar se në vitet 2015 - 2017 ka shpenzuar për punime të brendshme – në apartamentin e blerë në vitin 2007, ndodhur në Durrës – vlerën totale prej 1.800.000 lekësh;
- iii. Nga përmbajtja e përgjigjes së sipërcituar, konstatohet se në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, ka shpenzuar për punimet në fjalë shumën prej 579.395 lekësh, ndërsa shuma e mbetur, nga totali prej 1,8 milion, pra, shuma 1.220.605 lekë, sipas deklaratimeve të subjektit, është shpenzuar për këtë apartament gjatë viteve 2016 dhe 2017;
- iv. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike për vitet 2015 - 2017, shpenzime me vlerë mbi 300.000 lekë, detyrim ky i parashikuar nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar;

<sup>9</sup> Ky zë shpenzimi del nga përmbajtja e faturave që ka paraqitur subjekti, pasi jo të gjitha faturat u referohen materialeve të ndërtimit, por mes tyre rezultojnë edhe blerje të pajisjeve arredeuse.

<sup>10</sup> Kredia në fjalë ka qenë 15.000 euro, por subjekti deklaroi se vetëm një pjesë të tyre – pra vetëm 760.000 lekë – ka përdorur për përfundimin e punimeve në apartamentin në fjalë.

- v. Gjithashtu, në deklaratën e vitit 2006, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë prej 15.000 eurosh, për kryerjen e punimeve të apartamentit, por ai nuk e ka deklaruar si një shpenzim të kryer shumë prej 760.000 lekësh, të përdorur për përfundimin e punimeve të brendshme, në apartamentin e blerë në vitin 2005;

Sa më lart bazohet në:

- a- Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar;
- b- Formularët periodikë vjetorë të deklarimit të pasurisë në vitet 2006, 2015, 2016, 2017;
- c- Deklarimet, shpjegimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetësonin nr. 1, 2, 4 dhe 5.

### **6.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

- vi. Subjekti, lidhur me këtë pikë, specifikoi se shumatat e deklaruara – si më lart – janë përdorur për punime ndërtimi dhe jo për arredim, duke bërë referim tek disa fatura të administruara nga Komisioni, të cilat veçmas – sipas tij – nuk tejkalonin pragun mbi të cilin duhej të deklaroheshin shpenzimet e kryera, për rrjedhojë subjekti këtë nuk e ka konsideruar si një shkelje, apo mungesë;
- vii. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur deklarata noteriale nga persona që kishin dijeni mbi kryerjen e punimeve në fjalë – të cilat janë administruar nga Komisioni – si dhe ka kërkuar dëgjimin e tyre si dëshmitarë. Këtë kërkesë Komisioni, në bazë të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 nuk e vlerësoi të nevojshme për vendimmarrje pasi personat në fjalë e kishin shprehur qëndrimin e tyre nëpërmjet deklaratave të sipërcituara;

### **6.2 Vlerësimi i trupit gjykues**

- viii. Komisioni, vlerëson se lidhur me shpenzimet e deklarueshme, arritja ose jo e pragut që pasjell detyrimin ligjor për deklarimin e tyre, duhet të përllogaritet në totalin e shpenzimit përkatës, të kryer në harkun kohor të vitit për të cilin referon deklarata e paraqitur nga subjekti, dhe nuk rezulton korrekte mënyra e analizimit veçmas dhe në vetvete për çdo shpenzim apo blerje të kryer brenda vitit deklarues, edhe kur ato i përkasin të njëjtës kategori shpenzimi;
- ix. Në rastin konkret, të gjitha shpenzimet e kryera për punimet e brendshme të apartamenteve në fjalë, duhej që të ishin deklaruar nga momenti që ato, në tërësinë e shpenzimeve të kryera për këtë qëllim në vitin respektiv, tejkalonin pragun e parashikuar nga legjislacioni në fuqi;
- x. Për sa i përket deklarimit të vitit 2006, trupi gjykues, vlerëson se – subjekti ka deklaruar kredinë e marrë, në vlerën 15.000 euro, me qëllim pikërisht, kryerjen e punimeve të

brendshme në apartamentin e blerë në vitin 2005 – dhe për rrjedhojë nuk ka pasur mangësi në këtë deklaram;

- xi. Lidhur me punimet e brendshme të kryera në apartamentin e blerë në vitin 2007, Komisioni, çmon se deklarata e vitit 2015, si dhe së paku njëra nga deklaratat e viteve 2016 dhe 2017, rezultojnë të kenë qenë të pamjaftueshme. Ky konkluzion bazohet në kombinimin e argumentimit të mësipërm – mbi mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të së njëjtës kategori – me faktin që vetë subjekti i rivlerësimit ka pohuar<sup>11</sup> se përgjatë vitit 2015 ka shpenzuar shumë prej 579.395 lekësh (408.295 + 171.100) për punime të brendshme në apartamentin e sipërcituar – por pa i deklaruar ato në këtë vit, në rubrikën përkatëse;
- xii. Shumat e shpenzuara në vitet 2016 dhe 2017, që - sipas deklarimeve të subjektit – duhet të përbëjnë shumë totale prej 920.605 lekësh (1.500.000 - 579.395), nuk janë specifikuar nga subjekti se cilat janë shumat përkatëse të shpenzuara për secilin vit. Gjithsesi, përveç vitit 2015, si më lart, edhe në rast se do të konsiderohej si shpenzim në njërin nga këto dy vite (2016 ose 2017), një shumë më e lartë ose e barabartë me 621.000 lekë, do të duhej të ishte deklaruar në vitin përkatës, pasi është kapërcyer pragu i shpenzimeve të deklarueshme, duke e konsideruar në këtë rast jo të duhur deklaramin e pjesës së mbetur të shpenzimit të kryer në vitin tjetër. Ndërsa, nëse shpenzimet e kryera në vitet 2016 dhe 2017 do të konsideroheshin si të barabarta ose të përafërta me njëra-tjetrën – pra, nëse diferenca midis tyre do të ishte më e vogël se hipotizimi i mësipërm – detyrimi i deklarimit të tyre do të binte mbi të dy vitet në fjalë. Për rrjedhojë, edhe këtu ndodhemi përballë, së paku, dy deklarimeve të pamjaftueshme.

## **7- Rezultatet e analizës financiare**

- i. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, ka kryer analizën financiare, duke u bazuar në sa më poshtë:
  - a. deklaramet e bëra ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së;
  - b. provat shkresore të administruara nga ana e ILDKPKI-së;
  - c. dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit;
  - d. deklaramet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit, përmes postës elektronike, gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit;
  - e. provat shkresore të administruara nga Komisioni, nga institucione publike dhe private;
  - f. analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit;
  - g. çdo dokument që përbën mjet prove sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>11</sup> Në pyetësin nr. 2, përgjigja nr. 2, pika b. Kryerja e këtyre shpenzimeve konfirmohet, gjithashtu, edhe nga faturat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.



- ii. Duke bërë një përmbledhje të përgjithshme të përlogaritjeve në bazë të të ardhurave neto të siguruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga aktiviteti profesional i bashkëshortes<sup>12</sup> së subjektit, rezultoi se në disa vite bilanci është negativ. Përkatësisht, në vitet 2005, 2007, 2008, 2010, 2013, 2014 dhe 2016, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën totale prej 3.044.938 lekësh për të përballuar shpenzimet e kryera dhe njëkohësisht për të mundësuar kursimet e realizuara, sipas deklaratave periodike, por edhe sipas shpjegimeve që subjekti ka dhënë në përgjigje të pyetësorëve, si dhe në bazë të të dhënave bankare;
- iii. Gjithashtu, është konstatuar se të dhënat e deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit shpesh nuk përkonin me përmbajtjen e dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe, për rrjedhojë, midis rezultateve që dalin nga përpunimi i deklaratave të subjektit dhe rezultateve të arritura nga lëvrimi i shifrave të dokumentuara, rezultoi një diferencë e konsiderueshme – si në krahasim me deklaratimet e kryera, po ashtu edhe në krahasim me analizën financiare të kryer nga auditit i zgjedhur nga subjekti - të administruar nga Komisioni. Rezultatet e analizës financiare të të ardhurave, bazuar në dokumentacionin zyrtar të administruar nga Drejtoria Tatimore dhe nga punëdhënësi - të pasurive, të detyrimeve dhe të shpenzimeve për çdo vit, përgjatë periudhës 2003 - 2016, janë pasqyruar në tabelën përmbledhëse, si vijon:

#### **Analiza financiare për periudhën 2003 - 2016**

<b>Vitet</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>Pasuri neto</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Pasuri neto + shpenzime</b>	<b>Të ardhura - (Pasuri neto + shpenzime)</b>
2003	894,013	122,820	252,405	375,225	518,788
2004	5,075,930	3,101,477	726,747	3,828,225	1,247,705
2005	1,358,734	553,912	1,356,240	1,910,152	-551,419
2006	2,831,988	-228,820	2,567,528	2,338,709	493,279
2007	3,534,600	2,713,695	1,518,477	4,232,173	-697,573
2008	3,992,817	3,043,469	1,507,273	4,550,742	-557,925
2009	4,093,546	2,163,507	1,776,494	3,940,001	153,545
2010	3,061,703	2,279,519	1,471,023	3,750,543	-688,840
2011	3,242,827	1,546,534	1,361,033	2,907,566	335,261
2012	3,937,821	1,386,461	1,817,052	3,203,513	734,308
2013	3,681,408	1,238,256	2,663,324	3,901,580	-220,172
2014	4,100,222	1,460,655	2,797,944	4,258,599	-158,377
2015	5,474,578	2,380,478	3,011,405	5,391,883	82,695
2016	4,944,649	2,311,933	2,803,350	5,115,283	-170,634

<sup>12</sup> Llogaritja e të ardhurave të bashkëshortes së subjektit është bazuar në konfirmimin zyrtar të marrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2019, dhe praktikës bashkëlidhur kësaj shkrese, të administruar nga Komisioni.

- iv. Si rezultat i analizës financiare, të përmbledhur më lart, për subjektin e rivlerësimit rezulton një mungesë e burimeve financiare të ligjshme, në total në shumën - 3,044,938 lekë.
- v. Gjithashtu, duhet theksuar se, në sajë të sa është përshkruar edhe në pikat më sipër, janë konstatuar disa deklarime periodike të pamjaftueshme, dhe disa të tjera me pasaktësi, pasi ato nuk kanë përshkruar të ardhura edhe disa shpenzime të kryera, si dhe kanë rezultuar pasqyrimet të dhënash – sidomos të ardhura – të ndryshme nga ato që janë evidentuar dhe verifikuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni;

## 7.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me analizën financiare

- vi. Në lidhje me të dhënat e lëvruara në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit – nëpërmjet shpjegimeve të dhëna, analizës financiare të kryer nga auditi i zgjedhur prej tij, si dhe provave të përcjella në Komision, lidhur me rezultatet e hetimit që i ishin komunikuar, por edhe nëpërmjet argumentimeve të hollësishme dhe të gjata që ai bëri në seancën dëgjimore – paraqiti disa vërejtje të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, në lidhje me: përlllogaritjen e fitimeve të realizuara nga bashkëshortja e tij; korigjimin e disa pasaktësive të analizës financiare të Komisionit; administrimin dhe marrjen në konsideratë të analizës financiare të paraqitur nga auditi i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit; modifikimin e përlllogaritjes mbi shpenzimet e disa udhëtimeve, që – sipas tij – ishin zyrtare dhe ishin kryer me shpenzime institucionale dhe jo prej tij, duke kërkuar mosllogaritjen e tyre në analizën financiare; pranoi mosdeklarimet e sakta të të ardhurave të realizuara nga bashkëshortja e tij, por i konsideron ato si pasaktësi të përlllogaritjeve të gabuara nga bashkëpunuesja e saj, dhe nga kujdesi i munguar dhe jo si deklarime të pamjaftueshme; kundërshtoi metodologjinë e përlllogaritjes së shpenzimeve jetike, pasi sipas tij ato janë përlllogaritur më të larta nga ato reale;
- vii. Gjithashtu, subjekti ka pohuar që mospërputhjet e shumave të fituara nga bashkëshortja e tij ndër vite, me ato që janë deklaruar periodikisht, shpjegohen me faktin se ndër vite janë deklaruar shifrat sipas konstatimeve të momentit, por më pas duke kuptuar që përlllogaritjet përgjatë viteve, lidhur me biznesin e bashkëshortes kishin probleme, ata i ishin drejtuar drejtorisë tatimore përkatëse, si në vitin 2013, po ashtu edhe në vitin 2017 për të kryer verifikime dhe për të qartësuar cilat kishin qenë “të ardhurat e vërteta neto”, mbi të cilat të paguheshin taksat;
- viii. Pas verifikimeve të kryera nga Drejtoria Tatimore, bashkëshortja e subjektit ka paguar diferencën e tatimeve në vitin 2017, dhe po në të njëjtën periudhë janë paguar edhe tatimet lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme. Sipas subjektit, këto pagesa, edhe pse të vonuara, i kanë legjitimuar të ardhurat respektive;
- ix. Lidhur me disa pretendime specifike të subjektit mbi zëra specifike të analizës financiare dhe mbi metodologjinë e përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni (do të flitet në vijim) duke përshkruar edhe qëndrimin e mbajtur nga trupi gjykues në lidhje me kërkesat në fjalë me argumentimin respektiv;

## 7.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me rezultatet e analizës financiare

- x. Për sa më lart, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit, duke i pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve të tij bindëse<sup>13</sup> në rezultatet financiare të viteve respektive;
- xi. Në lidhje me përllogaritjen e kostos së jetesës, Komisioni e vlerëson të pabazuar kundërshtimin dhe pretendimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pasi rezulton të jetë aplikuar një kosto jetese minimale dhe standarde, për sa kohë ajo pasqyron minimumin e nevojshëm për një jetë të thjeshtë afër limiteve të mbijetesës;
- xii. Nëse do të përllogariteshin me shifra më reale dhe të segmentuara për çdo zë: ushqimi, faturat e energjisë elektrike, të ujit, të shërbimeve televizive, interneti, pastrimi dhe mirëmbajtja e banesave dhe e autoveturave, siguracionet e ndryshme, argëtimeve të mundshme (si p.sh., frekuentimi i restoranteve, bareve, hoteleve, udhëtimeve dhe pushimeve brenda vendit, palestra, shërbime për mirëmbajtje trupit), shpenzime të mundshme mjekësore/dentare, etj. – sigurisht që do të arrinin në një shumëfish të shumës së përllogaritur nga Komisioni për shpenzimet jetike për çdo familje të shtresës së mesme, kudo që ajo të ketë banuar;
- xiii. Për sa i përket mosdeklarimit të të ardhurave të bashkëshortes për vitin 2012, – nga shitja e pjesës takuese të pasurisë që është trajtuar më lart – ashtu si edhe për mospërputhjen e shifrave të pasqyruara ndër vite si fitime të realizuara nga aktiviteti i znj. B.(E.)P., siç është argumentuar edhe më sipër, ato vlerësohen dhe konsiderohen si deklarime të pamjaftueshme dhe të pasakta, sipas rastit, në përputhje me dispozitat ligjore;
- xiv. Gjithashtu, subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni ka pretenduar se diferenca pozitive e rezultuar nga analiza financiare në fund të vitit 2004 – e cila nuk është deklaruar në ILDKPKI-ja nëpërmjet deklarimit të këtij viti, në rubrikën përkatëse, si një kursim i poseduar në gjendje *cash* – t'i merrej në konsideratë si gjendje likuiditetesh, pasi, sipas tij, këto kursime ai i kishte mbartur dhe i kishte përdorur në vitin 2005, vit në të cilin subjekti rezulton me mungesë burimesh financiare;
- xv. Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë pretendim të subjektit pasi, detyrimi ligjor i subjekteve deklaruese për deklarimin e vlerës së likuiditeteve, gjendjes në *cash*, etj., para fillimit të detyrës, si dhe në çdo vit, ndryshimet e ndodhura deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, është detyrim i përcaktuar shumë qartë që në fillim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve, dhe të disa nëpunësve publikë", botuar në Fletoren Zyrtare, nr. 31, maj 2003;

<sup>13</sup> Si për shembull: zbritja e shpenzimeve për disa udhëtime institucionale; konsiderimi i kostos së automjetit duke zbritur shumën e kthyer mbrapsht të TVSH-së; përfshirja në analizë të të ardhurave nga shitja e pjesës takuese së apartamentit në vitin 2012; spostimi i kostos për blerjen e autoveturës tip "Feelander" në vitin 2006 – sipas kërkesës së drejtë të subjektit; marrja në konsideratë e të ardhurave shtesë nga puna e bashkëshortes si dhe nga qiraja e pronës, neto, lidhur (vetëm) me shumat e pasqyruara në shpresën e Drejtorisë Tatimore – edhe pse pagesa e tatimeve të tyre ishte kryer në vitin 2017.

- xvi. Lidhur me shpenzimet e kryera për blerjen e automjetit në datën 09.11.2006, Komisioni mori në konsideratë pretendimet e subjektit, pasi këto shpenzime duhej të reflektoheshin – dhe u reflektuan – në analizën financiare të subjektit, për vitin 2006, dhe jo në vitin 2005;
- xvii. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti ka shprehur mosdakordësi lidhur me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes në vitin 2007, pasi sipas tij diferenca midis deklaramit dhe të ardhurave *de facto* është fare e vogël;
- xviii. Komisioni, në pasqyrimin dhe përlllogaritjen e të ardhurave në fjalë, si për të gjithë subjektet dhe për të gjitha vitet e analizuara, i është referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ dhe në rastin konkret për të ardhurat e subjektit i është referuar vërtetimeve të punësimit nga institucionet përkatëse ndërsa lidhur me të ardhurat e bashkëshortes janë përdorur të dhënat e përcjella nga Drejtoria Tatimore;
- xix. Lidhur me shpenzimet për udhëtimet e kryera janë marrë në konsideratë dhe përlllogaritur shifrat sipas deklarimeve të subjektit, i cili ka pohuar se për vitin 2007 shpenzimet e udhëtimit kanë qenë 150.000 lekë. Në të gjitha vitet kur subjekti ka deklaruar shifra të caktuara për shpenzimet për udhëtime, ato janë marrë në konsideratë në analizën financiare, pasi nuk kanë rezultuar më të vogla se shifrat minimaliste të paracaktuara;
- xx. Gjithashtu, të ardhurat nga qiraja për vitet 2009 - 2012, janë përlllogaritur të plota, si e ardhur e subjektit – pa zbritur nga shuma e të ardhurave tatimin prej 15 %, pasi detyrimet tatimore për këtë periudhë janë paguar në dhjetor të vitit 2017;
- xxi. Lidhur me analizën e vitit 2010, subjekti ka provuar se ka marrë mbrapsht shumën prej 19%, pas blerjes së autoveurës tip “Benz”, në shumën 2.500.000 lekë, për shkak se ajo ishte blerë në Gjermani<sup>14</sup>, dhe pas regjistrimit të saj në Shqipëri, rimburohet TVSH-ja, meqenëse është një vend jashtë Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, në analizën financiare është konsideruar edhe zbritja prej 19 % lidhur me çmimin e kësaj autoveure. Lidhur me këtë rrethanë është paraqitur një deklaratë noteriale e z. Xh. V., dhe është kërkuar që ai të dëgjohej si dëshmitar, por Komisioni, nuk e pa të nevojshme dëgjesën e tij, pikërisht sepse ai e kishte shprehur qëndrimin e tij nëpërmjet deklaratës në fjalë;
- xxii. Në analizën financiare të vitit 2012 janë marrë në konsideratë të ardhurat nga shitja e një apartamenti të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit (i përfituar nga privatizimi por i padeklaruar nga bashkëshortja e subjektit në deklaramin e parë të saj), në shumën 700.000 lekë, të cilat nuk ishin deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012, por janë deklaruar në deklaratën për “Vetting” si burim. Gjithashtu, ato rezultojnë të provuara si e ardhur nga një kontratë shitjeje e vitit 2012, në shumën 4.000.000 lekë, dhe ku bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit kishte ¼ pjesë takuese të këtyre të ardhurave në shumën 1.000.000 lekë;

---

<sup>14</sup> Ky fakt është verifikuar edhe në raste të tjera, specifikisht për një tjetër autoveurë të po këtij subjekti është provuar rimbursimi i 19 % të çmimit nëpërmjet transfertës bankare, dhe për analogji, Komisioni, vlerëson ta shtrijë këtë efekt financiar edhe në rastet e tjera të ngjashme. Për më tepër, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale dhe ka kërkuar thirrjen e dëshmitarëve lidhur me marrjen pas të TVSH-së, dhe Komisioni nuk e pa të nevojshme të dëgjonte dëshmitarët pasi ata ishin shprehur nëpërmjet deklaratave noteriale.

- xxiii. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar kthimin e shumës prej 19 % për automjetin e blerë në vitin 2014, në shumën 1.700.000 lekë, shumë e cila i është kthyer subjektit nëpërmjet sistemit bankar dhe vlera e automjetit në analizën financiare është konsideruar me zbritjen prej 19 %;
- xxiv. Në analizën financiare të vitit 2013 janë marrë në konsideratë të ardhurat nga shitja e një apartamenti të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. në shumën 300.000 lekë, të cilat nuk ishin deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013, por ishin deklaruar si burim në deklaratën për “Vetting”. Për këtë rrethanë është paraqitur një deklaratë noteriale e znj. F.P., dhe është kërkuar marrja e saj si dëshmitare, por Komisioni e pa të panevojshme dëgjuesën e saj;
- xxv. Lidhur me analizën financiare të viteve 2015 dhe 2016,<sup>15</sup> subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime mobilimi, por vetëm shpenzime për punime të brendshme në shtëpi si: punime të ndërtimit, elektrike, hidrosanitare, etj. Këto deklarime të subjektit u morën parasysh pasi ndryshimi ishte në tipologjinë e shpenzimeve dhe jo mbi shumat, dhe për rrjedhojë, në vitin 2015 janë llogaritur shpenzime për punime të brendshme në shumën 707.828 lekë, dhe për vitin 2016 në shumën 500.000 lekë;
- xxvi. Në sajë të rezultateve financiare të shpjeguara më lart, u konstatua një mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën prej 3.044.938 lekësh, në periudhën 2005 - 2016, që të mund të mjaftonin për të përballuar të gjitha shpenzimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit në periudhat respektive, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se, në prezencën e deklarimeve të pamjaftueshme dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, duhet aplikuar neni D, i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **B - Procesi i rivlerësimit për kontrollin e figurës**

- i. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së z. Ferdinand Elezi dhe ka dërguar një raport, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar, “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit”. Ky raport është deklasifikuar<sup>16</sup> në datën 20.02.2018;
- ii. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione që subjekti të ketë pasur ose të ketë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;

<sup>15</sup> Në vitin 2016 subjekti i rivlerësimit ka blerë automjet për bashkëshorten e tij me vlerë 13.000 euro, konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të “Bankës së Shqipërisë” për vitin 2016 plus taksat në vlerën 367.000 lekë; në total vlera e blerjes së automjetit është 2.125.510 lekë. Autovetura e blerë atë vit është shitur në vlerën 15.000 euro, konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të “Bankës së Shqipërisë” për vitin 2016.

<sup>16</sup> Vendim nr. 172, datë 20.07.2018.

- iii. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk është konstatuar ekzistenca e ndonjë kontakti të papërshtatshëm me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës;
- iv. Për sa më lart, Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, nuk ka gjetur të dhëna apo prova që mund të ngrinin dyshime mbi ekzistencën e fakteve apo rrethanave që mund të ndryshonin vlerësimet dhe konkluzionet e DSIK-së, dhe për rrjedhojë çmon se, për sa i përket kriterit të figurës, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

### **C - Rivlerësimi i aftësive profesionale**

Lidhur me rivlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka administruar raportin e përgatitur nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme – si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Nëpërmjet këtij raporti, Grupi i Punës ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a. Aftësitë profesionale;
- b. Aftësitë organizative;
- c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- d. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e akteve dhe dokumenteve të mëposhtme:

- i. Formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii. Pesë dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii. Të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, si dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

## GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si më poshtë:

### a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka deklaruar të dhënat statistikore që lidhen me veprimtarinë në përgjegjësinë e tij, duke referuar si periudhë të rivlerësimit 01.01.2014 - 31.12.2016.

### b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Duke iu referuar të dhënave mbi veprimtarinë profesionale të deklaruara nga subjekti dhe dokumenteve shoqëruese, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka punuar dhe punon në organin e Prokurorisë, është angazhuar në procesin e mësimdhënies në universite dhe në cilësinë e ekspertit në Shkollën e Magjistraturës, si dhe është autor i një sërë punimesh shkencore, dhe më konkretisht:

Në prokurori:

- Për periudhën gusht 1997 – korrik 1999 ka ushtruar funksionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
- Për periudhën korrik 1999 – nëntor 2003 ka ushtruar funksionin e prokurorit në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
- Për periudhën nëntor 2003 – qershor 2005 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
- Për periudhën qershor 2005 – korrik 2006 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Për periudhën korrik 2006 – tetor 2013 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
- Për periudhën tetor 2013 dhe në vazhdim ushtron detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Në procesin e mësimdhënies:

- Në cilësinë e ekspertit në Shkollën e Magjistraturës.
- Në cilësinë e autorit të punimeve shkencore.

### c) Detyrat e kryera tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, ka deklaruar se për periudhën 2013 - 2016 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, detyrë kjo që përfshihet në të drejtën penale, materiale dhe procedurale.

d) Trajnimet në tre vitet e fundit

Për sa i përket trajnimeve të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda periudhës së rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, ka deklaruar në formular pjesëmarrjen e tij në disa trajnime.

e) Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tre dokumente ligjore, konkretisht:

1. Dokumenti ligjor “Konkluzione” i datës 25.05.2016, “*Mbi vendimin penal nr. \*\*\*, datë 24.07.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndaj të pandehurit F. D*”.
2. Dokumenti ligjor, objekt vlerësimi, mban datën 25.05.2016, pra, është brenda periudhës së rivlerësimit.
3. Dokumenti ligjor “Konkluzione” i datës 07.07.2016, “*Mbi vendimin penal nr. \*\*\*, datë 17.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ndaj të pandehurit Xh. N, etj.*”.
4. Dokumenti ligjor “Konkluzione” i datës 15.02.2015, “*Mbi vendimin penal nr. \*\*\*, datë 18.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*”.

f) Dokumente të tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe 12 dokumente të tjera.

## PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE PËR PROKURORIN FERDINAND ELEZI, TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Prokurori Ferdinand Elezi, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 750 çështje (691 çështje penale me objekte të ndryshme, 57 rekurse për çështje themeli dhe dy urdhra administrativ). Ky fakt konfirmohet nga lista e çështjeve të përgatitura për short.

### Dosja 1

Konkluzione, datë 21.05.2015, mbi ankimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 17.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Me këtë dokument ligjor, “Konkluzione”, subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, në mbështetje të nenit 428/1, pika c, të Kodit të Procedurës Penale ka kërkuar:

*“Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 17.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të akuzuarit V. Gj, për shkak se vepra penale për të cilat ai është akuzuar nga i dëmtuari akuzues, janë amnistuar nga ligji nr. 22/2014, datë 10.03.2014, ‘Për dhënie amnistie’”.*

Nga përmbajtja e dokumentit ligjor “Konkluzione”, përpiluar nga prokurori Ferdinand Elezi, konstatohet se janë respektuar rregullat drejtshkrimore, teksti është i ndarë në paragrafë, fjalitë



janë të qarta, vendosen referencat ligjore përkatëse penale e procedurale për ta bërë më të saktë dhe të kuptueshëm arsyetimin e qëndrimit që prokurori ka në lidhje me çështjen në fjalë.

Pas paraqitjes së konkluzionit nga ana e prokurorit, subjekti i rivlerësimit, dhe pretendimit të ankuesit, Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.05.2015, ka vendosur:

*“Prishjen e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 17.02.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe pushimin e çështjes penale”.*

## **Dosja 2**

Konkluzione, datë 27.06.2016, mbi ankimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 05.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të pandehurën E. M.

Me këtë dokument ligjor, “Konkluzione”, subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, në mbështetje të nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale ka kërkuar:

*“Mospranim ankimi ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 05.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të pandehurën E. M, meqenëse u hoq dorë nga ankimi.”*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, ka përfaqësuar organin e Prokurorisë, pranë Gjykatës së Apelit Durrës duke përgatitur konkluzionet e datës 27.06.2016.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.06.2016, Gjykata e Apelit Durrës, ka vendosur:

*“Mospranimin e ankimit të të pandehurës ndaj vendimit nr. (\*\*\*)\*\*\*, datë 05.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të heqjes dorë nga ankimi nga e pandehura E. M.”*

Prokurori Ferdinand Elezi referuar dispozitave penale e procedurale të cilat i ka cituar konkretisht, ka argumentuar pabazueshmërinë ligjore të pretendimeve të të pandehurës për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke shprehur qartë qëndrimin e tij se ankimi i të pandehurës nuk duhet të pranohet.

## **Dosja 3**

Konkluzione, datë 11.05.2016, “Mbi vendimin nr. \*\*\*, datë 05.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndaj të pandehurit B. B” dhe rekursi, datë 26.07.2016. “Ndaj vendimit penal nr. \*\*\*, datë 29.06.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës”.

Në dokumentin ligjor, “Konkluzione”, subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, në mbështetje të nenit 428/1, pika a, të Kodit të Procedurës Penale ka kërkuar:

*“Lëniën në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, (\*\*\*)\*\*, datë 05.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për të pandehurin B. B në lidhje me deklarimin fajtor, cilësimin ligjor të veprës penale dhe masën e dënimit dhënë ndaj tij”.*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, ka përfaqësuar organin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës duke përgatitur konkluzionet e datës 11.05.2016.

Dokumenti “Konkluzione”, përbëhet nga tre pjesë: pjesa hyrëse, pjesa arsyetuese dhe konkluduese.

Nga përmbajtja e dokumentit “Konkluzione”, konstatohet se janë respektuar rregullat drejtshkrimore, teksti paraqitet i ndarë në paragrafë, fjalitë janë të formuluar qartë dhe të

kuptueshme, përmenden dispozitat përkatëse penale e procedurale për ta bërë më të kuptueshëm përmbajtjen e dokumentit dhe kërkimet përfundimtare.<sup>17</sup>

#### Dosja 4

Konkluzione, datë 18.11.2013, “Mbi vendimin penal nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 12.10.2013, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Në dokumentin ligjor “Konkluzione”, subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, në mbështetje të nenit 249/6 dhe nenit 428, pika b, ka kërkuar:

*“Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 12.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan mbi masën e sigurimit “arrestit në burg” sipas nenit 238 të Kodit Procedurës Penale ndaj shtetasit nën hetim K. K. – Miratimin e vendimit për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë.”*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, në përfaqësimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në gjykimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Durrës, ka përpiluar dokumentin “Konkluzione”, ku pasqyrohet qëndrimi i tij.

Dokumenti ligjor “Konkluzione”, është i strukturuar në pjesë – në pjesën hyrëse, përshkruese dhe pjesën konkluduese.

Dokumenti ligjor i përpiluar nga ana e subjektit të rivlerësimit paraqitet konform kërkesave procedurale penale dhe rregullave të drejtshkrimit. Prokurori është treguar i kujdesshëm për ta bërë tekstin e dokumentit ligjor të qartë e të kuptueshëm, duke e ndarë në paragrafë dhe numërtuar arsyet mbi të cilët mbështet qëndrimin e tij. Fjalitë janë në lidhje logjike dhe përmbajnë referencat ligjore përkatëse procedurale dhe penale.<sup>18</sup>

Pas dëgjimit të konkluzioneve të prokurorit dhe personit nën hetim, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 18.11.2013, ka vendosur ndër të tjera:

*“Miratimin e vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 12.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.*

#### Dosja 5

Konkluzione, datë 11.12.2014, “Mbi vendimin penal nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 21.03.2014, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Në dokumentin ligjor “Konkluzione”, subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, në mbështetje të neneve 316, 317, 318 dhe 428, pika b, ka kërkuar:

*“Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 21.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit G. Sh, me objekt, sigurimin e provës, si kërkesë e pabazuar në ligj.”*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Ai ka përgatitur dokumentin “Konkluzione”, datë 11.12.2014, ku ka kërkuar - *“Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit G. Sh, me objekt, sigurimin e provës, si kërkesë e pabazuar në ligj”.*

<sup>17</sup> Në fletën e dytë të konkluzionit vihet re që ka korrigjim të tri fjalëve mbi tekstin e shkruar në kompjuter.

<sup>18</sup> Në fletën e tretë të konkluzioneve vihet re se është shtuar me shkrim dore fjala “jo”.

Në pjesën hyrëse të tij, prokurori Ferdinand Elezi, subjekt rivlerësimi, jep të dhëna mbi subjektin që parashtron konkluzionet, vendin, data dhe ora, emërtimin e dokumentit, para kujt paraqiten konkluzionet dhe për cilën çështje paraqiten këto konkluzione.

Nga përmbajtja e dokumentit ligjor “Konkluzione” të përpiluar nga prokurori Ferdinand Elezi, subjekt rivlerësimi, konstatohet se paraqitet në përputhje me rregullat drejtshkrimore, teksti është i ndarë në paragrafë, fjalitë janë të qarta, vendosen referencat ligjore përkatëse penale e procedurale për ta bërë më të saktë dhe të kuptueshëm arsyetimin e qëndrimit që prokurori ka në lidhje me çështjen në fjalë.

Pas paraqitjes së konkluzionit nga ana e prokurorit Ferdinand Elezi, subjekt i rivlerësimit dhe pretendimit të ankuesit, Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë 11.12.2014, ka vendosur:

*“Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë 21.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Gëzim Shehi, me objekt, sigurimin e provës, si të pa bazuar në ligj.”*

#### TË DHËNAT ARKIVORE LIDHUR ME ANKESA, MASA DISIPLINORE DHE VLERËSIMET

Nga verifikimi i të dhënave nga 23 Prokuroritë e rretheve gjyqësore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi:

- i. Të jenë depozituar ndaj tij ankesa lidhur me punën e kryer.
- ii. Të ketë të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.
- iii. Të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).
- iv. Të ketë pasur ndaj tij procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- v. Lidhur me procedime disiplinore, nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, referuar edhe shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 22.02.2018, të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Ferdinand Elezi, rezulton se: Me urdhrin nr. \*\*\* , datë 28.03.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm është dhënë masë disiplinore: *“Kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë dhe konkretisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës për një periudhë 6 mujore”*.

- vi. Ndaj këtij urdhri për dhënie mase disiplinore, subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë,
- vii. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.04.2012, ka vendosur:
  - a. *“Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Ferdinand Elezi.*
  - b. *Shfuqizimin e aktit administrativ, urdhrin nr. \*\*\*, datë 28.03.2012, të Prokurores së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë “Për dhënie mase disiplinore ndaj prokurorit të Prokurorisë së Apelit Durrës, z. Ferdinand Elezi.*
  - c. *Fshirjen nga dosja personale e prokurorit, z. Ferdinand Elezi të masës disiplinore të dhënë me urdhrin nr. \*\*\*, datë 28.03.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.”*
- viii. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit me nr. \*\*\*, datë 30.04.2012, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Përgjithshme.
- ix. Gjykata e Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 08.06.2012, ka vendosur:
 *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Prokuroria e Përgjithshme e Republikës, kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 30.04.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë.”*

#### **Lidhur me vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi.**

Të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, janë si më poshtë:

- x. Vlerësimi “Shumë Mirë” dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014.
- xi. Vlerësimi “Shumë Mirë” dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015.
- xii. Vlerësimi “Shumë Mirë” dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

#### **D - Analiza e gjetjeve<sup>19</sup>**

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

#### **Aftësitë profesionale**

- a) Njohuritë ligjore

<sup>19</sup> Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73 - 76 të ligjit nr. 96/2016.

Nga analiza e tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Ferdinand Elezi është njohës shumë i mirë i ligjit dhe bën interpretim të saktë të tij. Në varësi të objektit të çështjeve të trajtuara, penale apo procedurale, prokurori Ferdinand Elezi, bën një analizë të qartë të dispozitave ligjore duke u ndalur në zbatimin e saj referuar të dhënave të rastit objekt gjykimi.

Në përgatitjen e akteve, subjekti i rivlerësimit, respekton dispozitat procedurale penale.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e përgatitura prej tij, janë të arsyetuara në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Këto akte paraqiten të strukturuara në pjesë, duke krijuar kështu një qëndrueshmëri dhe standardizim.

### **Aftësitë organizative**

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, ka kryer detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Gjatë kësaj periudhe, prokurori Ferdinand Elezi ka punuar jo vetëm në cilësinë e drejtuesit, por edhe ka marrë pjesë në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, prokurori Ferdinand Elezi, subjekt rivlerësimi, për shkak të detyrës që ka kryer, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

Bazuar në numrin e çështjeve të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se ka përballuar ngarkesën e punës, në afat dhe me efikasitet.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Nga analiza e tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit është i aftë profesionalisht në këtë pjesëmarrje dhe për qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, shfaq aftësi shumë të mira në administrimin e dosjeve.

## **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### **a) Etika në punë**

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

### **b) Integriteti**

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, si dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Referuar të dhënave në vlerësimet vjetore të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm për të në periudhën 2014 - 2016, figuron si person me integritet të lartë, i paanshëm dhe objektiv.

### **c) Paanësia**

Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Ferdinand Elezi. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Ferdinand Elezi, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

## **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

### **a) Aftësitë e komunikimit**

Nga tre dokumentet ligjore të vetë përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

### **b) Aftësia për të bashkëpunuar**

Në tre dokumentet ligjore si dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, prokurorit Ferdinand Elezi, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Komisioni, pasi ka rivlerësuar dosjet profesionale si dhe ka analizuar denoncimet e publikut të paraqitura pranë Komisionit nuk ka konstatuar problematika domethënëse etiko-profesionale,

lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi është konstatuar se përgjithësisht aktet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit pasqyrojnë rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm si dhe pretendimet e palëve.

Për sa më lart dhe në mangësi të denoncimeve nga publiku që mund të çonin në gjetje të problematikave të mundshme profesionale, Komisioni, konkludon se nuk janë konstatuar mangësi profesionale, të dukshme dhe domethënëse të subjektit të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, dhe për rrjedhojë ai arrin mbi nivelin minimal kualifikues, të kërkuar nga neni 59, pika 1, germa c, e ligjit nr. 84/2016.

**Në konkluzion, duke mbajtur parasysh që:**

**A- Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse, burimin e ligjshëm të disa të ardhurave, lidhur me shumat e specifikuara më sipër, sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.**

**B- Në lidhje me kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, dhe për rrjedhojë, për sa i përket figurës, ai konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

**C- Në lidhje me aftësitë profesionale subjekti i rivlerësimit arrin, së paku, nivelin minimal kualifikues, të kërkuar sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.**

**Trupi gjykues, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel besueshmërie, për sa i përket vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.**

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

**PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë

22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 09.04.2019.

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Firdes Shuli**  
**Kryesuese**

**Lulzim Hamitaj**  
**Relator**

**Olsi Komici**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*